



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
SEKTORI I MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

Nr. _____ prot

Bilisht më 01.12.2022

Drejtuar: www.Bashkia Devoll.al

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

**Për pranimin në Shërbimin e MZSH-së (Sektori për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi),
Bashkia Devoll**

KREU I-Pranimi në Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” Kreu III, neni 14/1 “pranimi në nivelin bazë të shërbimit të MZSH-së” dhe neni 15; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.97 datë 26.12.2019; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr.251, datë 14.02.2020; Shkresës nr.493, datë 25.01.2017 “Mbi përzgjedhjen e aplikantëve për punonjës të shërbimit të MZSH-së për nivelin bazë”, Bashkia Devoll njofton se në Sektorin e MZSH-së ka 2 (dy) vende të lira pune në nivelin bazë të këtij shërbimi në pozicionet e mëposhtme:

1. Asistent zjarrfikës 2 (dy) vende te lira

KREU II-Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës.

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shurjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjës së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. Zjarrfikësi është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjës së gjallë dhe pronës. Duhet të njoh dhe te zbatoje orarin e veprimeve, të dije pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në cdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njoh dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjedisëve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

Kërkesa të Përgjithshme për pranimin:

1. Të jetë shtetas shqipëtar
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë për të kryer detyra me rrezik të shtuar
4. Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucione të tjera
5. Të ketë mbaruar arsimin e mesëm
6. Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje
7. Të jetë i gjatë, jo më pak se 1.70
8. Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë osë në qendra të trajnimit zjarrfikës

KREU III-Dorëzimi i dokumenteve, kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Zyrën e Burimeve Njerezore –Sektori Menaxhimit Burimeve Njerezore, Bashkia Devoll këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit të Bashkisë (sektorit të shërbimit të MZSH-së)
2. Fotokopje e ID (kartë identiteti);
3. Çertifikatë familjare;
4. Një kopje të jetëshkrimit(CV);
5. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
6. Diplomë të njësuar me origjinalin të arsimit të mesëm(minimalisht);
7. Listë notash të njësuar me origjinalin;
8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (nëse ka);
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
11. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
12. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
13. Formulari i aplikimit (plotësimi i të cilit bëhet pranë zyrës së menaxhimit të burimeve njerëzore, Bashkia Devoll,
14. Vërtetim nga organet shëndetësore që nuk është përdorues i lendeve narkotike

Ky dokumentacion duhet të dorëzohet nga kandidati deri në datën 15.12.2022

Në datën **19.12.2022** , do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin (në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht (me e-mail) për shkaqet e moskualifikimit më datë **19.12.2022**

Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

Konkurimi: provimi me shkrim do të bëhen në datën **27.12.2022**, në mjediset e Bashkisë Devoll-Salla e Mbledhjeve, në orën 14-00.

Testi i aftësive fizike: i cili përmban, vrapim, peshën/gjatësi dhe testet e muskujve, dhe intervista me gojë do të zhvillohet **28.12.2022**

Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi

Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;

Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i Brendshëm”, i ngritur pranë Bashkisë Devoll. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 40 (dyzetë) pikë për testimin me shkrim, 20 (njëzetë) pikë për intervistën me gojë dhe 40 (dyzetë) pikë për testin fizik.

Lista përfundimtare e kandidatëve të përzgjedhur fitues: do të shpallet sipas rendit zbritës në datën 31.12..2022.

Njoftimi do të bëhet: në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, në datën 31.12.2022.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

Për sqarime, mund të kontaktoni ose në adresën: www.bashkiadevoll.al ,ose prane ambjenteve te Bashkise Devoll.

Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përgjithshme të sipërcituara.

Kandidatë fitues do të shpallen 2(dy) prej aplikantëve të renditur me pikët më të larta.

NJESIA E MENAXHMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

BASHKIA DEVOLL